



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 07.02.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 22.01.2019, 29.01.2019 dhe 31.01.2019 nga anëtarët e Këshillit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 22.01.2019, 29.01.2019 dhe 31.01.2019 nga anëtarët e Këshillit.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Në radhë të parë, ju falenderoj për pjesëmarrjen!

Prezenca është e të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Në radhë të dytë, kërkoj ndjesë pjesëmarrësve të jashtëm të mbledhjes për vonesën në orarin e fillimit. E kishim parashikuar që do fillonim në orën 12:00, por për shkak të ngarkesës së akteve që kemi punuar mbrëmë dhe sot deri vonë në mëngjes, e kishim të pamundur që të fillonim në kohën që kishim parashikuar. Besoj që kjo lloj vonese nuk do të ndodhi më në të ardhmen.

Atëherë, lidhur me rendin e ditës, siç jeni në dijeni, janë 6 pika në rendin e ditës. Së pari, është: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat: 22 janar, 29 janar dhe 31 janar. Së dyti, është: Shqyrtimi i projekt-rregullores “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”. Së treti, është: Shqyrtimi i projekt-rregullores “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve”. Së katërti, është: Shqyrtimi i projekt-rregullores “Mbi

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve”. Së pesti, është: Shqyrtimi i projekt-vendimit për “Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”. Dhe së fundi, pika 6, është: Shqyrtimi i një projekt-vendimit “Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”.

Për të kaluar tek çështja e parë e rendit të ditës, miratimi i procesverbaleve që përmenda më lart, jeni dakord që të kalohet me miratimin e procesverbaleve?

Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, Këshilli miratoi procesverbalet për mbledhjet e datës 29 janar, 22 janar dhe 31 janar.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 07.02.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projekt-rregullores “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projekt-rregullores “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i projekt-rregullores “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”.

Duke mbajtur parasysh detyrimet ligjore të nenit 45 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si edhe situatën e krijuar nga depozitimi në Këshill të një numri shumë të konsiderueshëm së kërkesave për delegim gjyqtarësh nga gjykata të ndryshme, si edhe në mbledhjen pararendëse kemi diskutuar pas konsultimeve të opinioneve të të dy misioneve, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projekt-rregulloren me detaje, lidhur me funksionimin e skemës së delegimit, ku ka parashikuar kriteret përkatëse dhe procedurën për funksionimin e saj.

Unë në fakt gjej vend të falenderoj në mënyrë të veçantë, kontributin që kanë dhënë misionet përkatëse, të cilët, për hir të së vërtetës, kanë asistuar anëtarët e Këshillit në çdo hap, duke diskutuar çdo vështirësi që kemi pasur për hartimin e projekt-rregulloreve që ka propozuar komisioni përkatës.

Dëshiroj që t'ia lë fjalën, për prezantimin e projekt-aktit, kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar projekt-rregulloren për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit. Kjo projekt-rregullore është bërë në zbatim të nenit 45 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Më herët historia ka filluar për shkak të ngarkesës/stokut të çështjeve për të cilat është kërkuar delegim. Kemi prej një muaji që diskutojmë rreth problematikës që është krijuar përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në një rast ky ka qenë edhe objekt i një mbledhjeje të veçantë. Kemi kërkuar që në fillim të herës një opinion nga dy misionet e huaja që mbështesin dhe asistojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor. Pas atij vendimi që kemi marrë dy javë më herët, pas një bashkëpunimi intensiv me të dy misionet por edhe me kontributin e të gjithë anëtarëve, jo vetëm të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, kemi arritur të përgatisim dhe finalizojmë një projekt-rregullore të dakordësuar nga të gjithë ne.

Besoj që projekt-rregullorja trajton të gjitha çështjet që ligji konsideron.

Në vijim kemi përgatitur edhe projekt-rregulloren për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve dhe kemi finalizuar edhe një plan veprimi me qëllimin e vetëm që stoku i çështjeve për të cilat ne duhet tashmë të operojmë, të ketë një adresim të drejtë dhe t'i ezaurojë ato.

Besoj që në projekt-rregulloren që keni për shqyrtim sot jemi përpjekur të detajojmë çdo element që ligji na ka ngarkuar, që rregullorja të jetë e kuptueshme dhe lehtësisht e aplikueshme nga të gjithë.

Nuk e di nëse do të ketë ndonjë pyetje nga anëtarët, por di që kemi diskutuar paraprakisht të gjithë së bashku edhe për këtë rregullore.

***Naureda Llagami:*** Ndonjë diskutim nga kolegët?

Jemi gati ta kalojmë në votim?

Atëherë, për një qartësi lidhur me procedurën e votimit, do propozoj që fillimisht projekt-aktin ta kalojmë në parim, më pas të kalojmë në votim nen për nen.

Jemi dakord me këtë lloj procedure?

Atëherë, po e hedh projekt-aktin në parim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

*(Vota e zonjës Kadi nuk është regjistruar. Sipas shënimeve të stenografes, zonja Kadi ka votuar Pro.)*

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, kalojmë nen për nen.

Neni 1.

**Maksim Qoku:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Unë dakord jam – pro – por ideja është që nëse nuk ka ndonjë pretendim nga anëtarët, t'i kalojmë të gjitha nenet dhe ai që ka pretendime, të ndalemi tek ato që kemi, mendoj unë. Thjesht për efekt kohe.

**Naureda Llagami:** Unë doja në fakt thjesht për të rregulluar pak procedurën, duke qenë se tek mbledhja e mëparshme kishim një lloj mosmarrëveshje për pjesën e hedhjes në votim të rregullores dhe unë dua që të gjithë ne të jemi koshient për çfarë votojmë. Nëse ne jemi dakord parimisht me aktin, atëherë, ato që kanë propozime konkrete për mos dakordësi për nenet konkrete, t'i lejmë që t'i ngrenë ato çështjet? E kalojmë parimisht dhe ia kalojmë fjalën atyre që nuk janë dakord me nenin konkret?

Okej, kemi ndonjë situatë që nuk është dakord me nenin konkret, ndonjë nga kolegët?

Tani, e hedhim në votim në tërësi rregulloren.

**Brunilda Kadi:** Në nenin 4, pika /e/ është një lapsus, ku thuhet “...i caktuar në një mënyrë të përhershme...”. Mund të jetë lapsus ajo fjala “...një...”, “...në një...”. Them unë, mos është lapsus.

**Naureda Llagami:** Administrata ta mbajë shënim, që të reflektohet.

Ta hedhim në votim në tërësi?

Po! Kalojmë projekt-aktin në tërësi.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Projekt-rregullorja u miratua me shumicë të votave, unanim, sipas përmbajtjes së propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Atëherë, çështja e tretë e rendit të ditës.

**Illir Toska:** Atëherë, tek projekt-vendimi që kemi përgatitur për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit, përveç miratimit të rregullores janë edhe disa vendimmarrje të tjera që besoj duhet t’i miratojmë. Duhet të jetë tek materialet e mbledhjes edhe një projekt-vendim.

Mund ta shpjegoj këtë?

Atëherë, tek projekt-vendimi, përveç pikës një që është: 1. Miratimi i projekt-rregullores, janë edhe disa pika të tjera: 2. Rregullorja hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare publikuar në faqen zyrtare të Këshillit (një përcaktim i tillë është bërë edhe në dispozitën e fundit të rregullores). Ka një disponim tek pika 3 e projekt-vendimit: 3. Çdo rregullim tjetër që bie ndesh me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore shfuqizohet.



Pika 4 është: 4. Të bëjë thirrje publike që brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqesin kërkesat për kandidimin në skemën e delegimit. Njoftimet publikohen në faqen zyrtare të Këshillit dhe t'i dërgohet kryetarëve të të gjitha gjykatave, dhe pesta është: 5. Për gjyqtarët që kanë aplikuar më parë në skemën e delegimit, t'u kërkohet që t'i rikonsiderohet kërkesa e tyre në funksion të zbatimit të kësaj rregulloreje.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë në votim projekt-vendimin për miratimin e rregullores, sipas tekstit të propozuar nga Komisioni.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Pro.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Pro.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 07.02.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projekt-rregullores “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projekt-rregullore “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës, lidhur me shqyrtimin e projekt-rregullore “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

Në vijim të miratimit të skemës së delegimit është miratuar gjithashtu edhe skema për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit, bazuar në nenin 46 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës edhe në këtë hartimin e kësaj rregulloreje, ka punuar ngushtësisht me misionet e USAID-it dhe EURALIUS-it dhe ka propozuar një projekt-rregullore të detajuar mbi kriteret dhe procedurat e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve. Për më tepër, fjalën ia kalojmë kryetarit të Komisionit, zotit Toska.

*Ilir Toska:* Edhe sa i përket kësaj rregulloreje, nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar. Jemi përpjekur të detajojmë të gjitha kriteret dhe rregullat që duhet të ndjekim për zbatimin e nenit 46 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sa i përket transferimit të përkohshëm të gjyqtarit. Qoftë miratimi i skemës së

delegimit, ashtu sa i përket transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, janë hapa që Këshilli duhet t'i ndërmarrë për të zgjidhur në finale situatën, këtë situatë që kemi praktikisht dhe çdo situatë tjetër që do të jetë në vijim. Besoj se kemi adresuar të gjitha shqetësimet që kanë pasur edhe kolegët më herët dhe drafti është i dakordësuar nga të gjithë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** E do njeri fjalën për diskutim?

Kalojmë në votim?

Atëherë, sikurse edhe në projekt-rregulloren e parë, projekt-rregullorja shoqërohet me një projektvendim, në të cilën pika e parë e projektvendimit është: 1. Miratimi i rregullores sipas tekstit bashkëlidhur. Së dyti: 2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit (pika 2), dhe pika e tretë: 3. Çdo rregull tjetër që bie ndesh me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore shfuqizohet. Pika 4: 4. Kthim pa veprime të çdo pëlqimi të dhënë për transferim të përkohshëm nga gjyqtarët të bërë para miratimit të rregullores. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. E kalojmë në parim projekt-rregulloren?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Kemi ndonjë nen për të cilin nuk jemi dakord? Të shprehemi?

E kalojmë në tërësi miratimin e rregullores?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Illir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Pro.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, sipas tekstit bashkëlidhur, të propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek pika e katërt e rendit të ditës, lidhur me shqyrtimin e projekt-rregullores mbi organizimin dhe funksionimin...

***Illir Toska***: Mos duhet të miratojmë edhe projektvendimin?

***Naureda Llagami***: Po ishte bashkëlidhur.

***Illir Toska***: U disponua për miratimin e rregullores, por edhe të projektvendimit.

***Naureda Llagami***: Atëherë, për saktësi, miratimin e projektvendimit bashkëlidhur rregullores, e hedhim në votim.

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Illir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Pro.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 07.02.2019)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projekt-rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Medi Bici** (anëtar)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projekt-rregullore “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”.

*Naureda Llagami:* Pra, kalojmë tek çështja e katërt e rendit të ditës, lidhur me shqyrtimin e projekt-rregullore “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”.

Siç jeni në dijeni, në mbledhjen paraardhëse, Këshilli ka miratuar ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Ky Komision ka përgatitur një projekt-rregullore, ku janë përcaktuar tërësia e rregullave për organizimin dhe funksionimin e këtij Komisioni, sigurimin dhe administrimin e dokumentacionit të Komisionit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Po ashtu, në këtë projekt të paraqitur janë përcaktuar edhe përgjegjësitë, detyrat dhe marrëdhëniet e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, Kolegjit të Posaçëm, strukturat mbështetëse ... administrative pranë tij, si dhe rregulla të hollësishme mbi krijimin, trajtimin,



qarkullimin, shfrytëzimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit që bëjnë pjesë në dosjen e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

Për më tepër, lidhur me këtë projekt-akt, fjala i jepet kryetarit të Komisionit, zotit Dritan Hallunaj.

***Dritan Hallunaj***: Po, faleminderit Kryetare!

Atëherë, në kuadër të vendimmarrjes së këtij Këshilli që mban numrin e vendimit 15, datë 22 janar 2019 mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, është përpiluar nga ana e këtij Komisioni një rregullore, një projekt-rregullore, duke pasur si bazë në zbatim të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë” si dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, si dhe atij 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Shkurtimisht, është vijuar në vazhden e një vendimmarrjeje që ka pasur edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që mban numër 49, datë 16.10.2017 ku janë përcaktuar etapat se si veprohet, se si do procedohet në lidhje me rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, që nga momenti i paraqitjes së dokumentacionit, kërkesës nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe në vijimësi pastaj të gjitha procedurat që do ndiqen pranë Këshillit në lidhje me vlerësimin e gjyqtarëve.

Kjo është reflektuar në një projekt-rregullore të përpiluar, e cila bëj me dije se është bërë e ditur një kopje e kësaj projekt-rregullores, së bashku me relacionin, edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ata të shprehnin ndonjë mendim apo paqartësi në lidhje edhe me standardizimin e vendimmarrjes apo raportit përfundimtar/produktit, që përcjell Këshilli pranë atij institucioni, duke pasur parasysh pra një vendimmarrje e tillë apo një marrëveshje e tillë të ishte një pjesë e paketës së miratuar me vendimin nr. 49, datë 16.10.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Është diskutuar edhe me kolegët paraprakisht dhe nuk është e nevojshme, mendoj unë, që të hyjmë në detaje, pasi e kemi diskutuar të gjithë bashkë edhe në mbledhje përpara se të futeshim në këtë mbledhje, në këtë seancë plenare dhe e gjithë problematika që shohim apo që diskutohet midis anëtarëve ka të bëjë me faktin nëse do jetë Këshilli ai

që do vlerësojë përfundimisht raportin që do t'i dërgohet KPK-së (pra Komisionit të Pavarur të Kualifikimit) apo do të jetë Komisioni ai që do të miratojë këtë, pra do jetë seanca plenare, apo Komisioni.

Vetëm për këtë pjesë kam përshtypjen që ka pasur, pra ka mendime të ndryshme dhe çmuj që ta hedhim në votim këtë pjesë apo të japin argumentet gjithsecili për atë pjesë që e vlerësojnë ose për pika të tjera, që ndoshta nuk janë dakord.

Pra në vija të përgjithshme kjo është. Është hedhur, ajo që thotë ligji, për një praktikë e mirë që ka pasur, është hedhur edhe një herë, është formatuar me përbërjen e re, me ndryshimet e reja me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Edhe një herë po e përsëris, një kopje i është dërguar edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të shfaqur mendim, por deri në këto momente nuk është se kanë shfaqur ndonjë mendim.

Për pyetje apo sqarime jam i gatshëm të përgjigjem.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kush e do fjalën lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni përkatës?

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, meqenëse s'ka njeri fjalën, ne jemi në dijeni që ka në fakt... është një rregullore por që ka dy mënyra të disponimit të përcjelljes së raportit që bëhet për vlerësimin e aftësive profesionale në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Në vlerësimin tim, por referuar Kushtetutës dhe ligjeve, ky raport nuk është raport vlerësues. Ky raport është një analizë e hollësishme që i bëhet subjektit të rivlerësimit sipas kriterëve të përcaktuara në ligj. Duke pasur natyrën e një raporti konstatues analizues, vlerësoj që nuk është e nevojshme që t'i kalohet për miratim mbledhjes plenare sepse nuk është në dispozitat kushtetuese që parashikojnë vendimmarrjet e mbledhjes plenare.

Nëse do të biem dakord që ky raport është një raport vlerësimi etik profesional, atëherë jam e mendimit që patjetër që duhet të kalojë në Këshill. Por ky raport nuk është vlerësim profesional sepse në zbatim të ligjit "Për rivlerësimin...", vlerësimin profesional të gjyqtarit e bën KPK-ja dhe nuk e bën KLGJ-ja. Roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktualisht është që nëpërmjet strukturave të veta dhe organeve të veta, t'i sigurojë mbështetje Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është organi që bën vlerësimin profesional të gjyqtarëve.

Problemi është që çfarë natyre ka Komisioni i Përkohshëm që ne kemi krijuar dhe a ka ai të drejta vendimmarrëse, le të themi në këtë aspekt.

Referuar ligjit “Për rivlerësimin...”, por referuar edhe Kushtetutës, konkretisht në pikën /e/ të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet që vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kohën kur kryhet rivlerësimi. Kushtetuta nuk ia ngarkon, në mënyrë të shprehur, këtë kompetencë, mbledhjes plenare. Po t’i referohemi dispozitave kushtetuese të mbledhjes plenare, parashikohet vetëm vlerësimi i gjyqtarit si një kompetencë që duhet të kalojë në mbledhje, pra vlerësimi etik profesional i gjyqtarit duhet të bëhet nga mbledhja plenare.

Në logjikën që ky raport është thjesht konstatues analizues i një situate të caktuar, nuk mund të jetë kompetencë e mbledhjes plenare sepse po ju them një situatë që, ne të 11 këtu do të vendosim që, -Po, jemi dakord me konkluzionin e këtij raporti, votojmë për vlerësimin sipas raportit/sipas projekt-aktit dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në fakt do të mendojë ndryshe, sepse kompetencën për të vlerësuar gjyqtarin e ka ai dhe jo KLGJ, pra mendoj që do të kemi mbivendosje të kompetencave. Së dyti, nga ana tjetër, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese për natyrën që ka Komisioni, kam mendimin që, pavarësisht se Gjykata Kushtetuese shfuqizoi dispozitën ligjore mbi kompetencat e mbledhjes plenare, parashikoi dhe dha versionin e vet për natyrën që ka Komisioni. Citoj pikën 19 të vendimit nr. 41 të datës 16.05.2017, thuhet: “19. Të gjitha kompetencat e tjera që nuk parashikohen në këto pika ushtrohen nga komisionet që janë organe...”, pra vetë Kushtetuta jep natyrën e organit Komisionit, “...nëpërmjet të cilave KLGJ-ja dhe KLP-ja organizohen dhe ushtrojnë funksionet e tyre. Komisionet ushtrojnë veprimtarinë dhe marrin vendime sipas fushave të tyre ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të këtyre të fundit. Në momentin kur ky është një akt analizues konstatues dhe nuk është një akt vlerësues, nuk e mendoj të nevojshme që ta kalojmë në mbledhje plenare sepse mbledhja plenare duhet të mbledhet për shkak të funksionit vendimmarrës që ka të saj. Nuk mund të mbledhet dhe të thotë, - Po, dakord, që ky projekt-akt t’i përcillet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sepse nuk është funksion i mbledhjes plenare.

Nga ana tjetër, gjithë kjo procedurë, që ta kalonim në Këshill, do të zvarriste shumë procesin e vlerësimit profesional të gjyqtarit, që ka karakter parësor, sepse secili ne anëtarët duhet të njihet jo vetëm me raportin, por edhe me të gjithë materialin, në qoftë se do të kalojë në votim të raportit. Prandaj jam në mbështetje të një nga propozimet e paraqitura nga ana e kryetarit të Komisionit të Përkohshëm që, me miratimin e raportit në Komision, automatikisht ai t'i përcillet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, mendoj që raporti që përgatitet në kuadër të procesit të rivlerësimit ka të bëjë me vlerësimin e aftësive profesionale. Nuk është thjesht një raport konstatues të dhënash. Fakti që ky raport konsiderohet si provë në një proces tjetër ligjor, siç është procesi i rivlerësimit dhe është institucioni që ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji që të bëjë vlerësimin profesional të gjyqtarëve, mund të ndaj pikëpamje të ndryshme sa i përket përgjegjësisë që buron për Këshillin nga Kushtetuta, ku flet për vlerësimin, nëse vlerësimi që bën fjalë Kushtetuta është vlerësimi periodik dhe ai për të cilin Këshilli duhet ta konsiderojë gjatë veprimtarisë së tij në raport me statusin e gjyqtarit, në një kohë që ky vlerësim që bëhet në kuadër të rivlerësimit është thjesht vetëm në funksion të këtij procesi dhe vendimin përfundimtar e merr një institucion tjetër, që s'është Këshilli. Nëse i ndajmë në këtë mënyrë, mundet që Komisioni të operojë dhe t'ia dërgojë raportet pa u hyrë në mbledhjet plenare. Përndryshe do të duhet ta vendosë Këshilli. Nëse biem dakord që vlerësimi që bëhet në kuadër të procesit të rivlerësimit nuk është vlerësimi që na thotë Kushtetuta dhe ligji "Për statusin e gjyqtarëve...", okej që kjo është një çështje që mund ta ndërmarrë vetë Komisioni. Në të kundërt do ta bëjë Këshilli...

**Naureda Llagami:** Po!

**Brikena Ukperaj:** Edhe referuar ligjit "Për rivlerësimin...", detyrën që e ngarkon Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me vlerësimin e aftësive profesionale, e referon tek statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Do të thotë që këtë vlerësim profesional do ta bëjë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve...". Roli që ka Komisioni në këtë rast dhe inspektori që do të përgatisë atë projekt-aktin është ndihmës për Komisionin e Pavarur, sepse duhet të kemi parasysh që ky Këshill do ta rimarrë në shqyrtim të njëjtin subjekt dhe do ta rivlerësojë për të njëjtën

periudhë vlerësimi sepse e ka në ligj. E ka në ligj që për të njëjtën periudhë vlerësimi, subjekti do rivlerësohet, por ky subjekt do të rivlerësohet për shkallën e aftësisë së tij profesionale. Në qoftë se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka thënë që ky arrin nivel minimal kualifikues, shkallën e këtij niveli “Shkëlqyeshëm”, “Shumë mirë”, “Mirë”, e bën Këshilli, pra ne do ta marrim në shqyrtim. Prandaj nuk mund të kemi ne një vlerësim dhe pastaj një rivlerësim për të njëjtën periudhë.

**Naureda Llagami:** Po, zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë jam me mendimin që duhet të kalojë në Këshill, për disa arsye. Referimi në termin ‘nëpunës’ që përmend Kushtetuta, unë jam, domethënë ndryshe nga interpretimi që bën Brikena, them që këtë koncept nuk e superon edhe fakti që përsëri këtë vendim do ta marrin prapë pesë anëtarë të Këshillit, pra nuk janë nëpunës, apo jo?! Edhe ata anëtarë janë. Thjesht janë 5, nuk janë 11. E dyta, kur thuhet – gjithmonë i referohem edhe diskutimit që bëri Brikena, argumentat që sjell, se patjetër që është e diskutueshme – kur thuhet nuk ka kuptim që 11 anëtarë të japin një vlerësim dhe pastaj KPK-ja ta rrëzojë, -për mendimin tim edhe 5 anëtarë po ta japin këtë vlerësimin, përsëri i njëjti argument është. Nuk do të thotë që 11 anëtarë janë më të rëndësishëm se 5 anëtarë.

**Brikena Ukperaj:** Jo! Më fal!

**Brunilda Kadi:** Ta mbaroj si ide.

Tjetra! Ky vlerësimi që u bëhet gjyqtarëve nga KPK-ja, për mendimin tim është shumë herë më i rëndësishëm sesa vlerësimi periodik profesional sepse është me pasoja shumë herë më... është me pasoja katastrofike. Vendimi, normal që bazohet në raportim, jo në vlerësimin tonë, por është shumë i rëndësishëm edhe raportimi. Kështu që unë mendoj që kur ligji i thotë ‘Këshilli e bën vlerësimin profesional periodik’, normal që edhe këtë raportimin që ka pasoja shumë herë më të rënda, duhet t’ia japë Këshillit si rëndësi.

Tjetra! Argumenti i fundit është që, për mua, gjithë kohës ligji e ka të qartë që thotë ‘Këshilli, Këshilli, Këshilli’ dhe mendoj që ka probleme vlefshmërie akti që ne do t’i përcjellim KPK-së. Se çfarë do ndodhë? Në një situatë të caktuar, jo tek i pari, tek i dyti – domethënë situata më ekstreme është kur një subjekt i 100-të për shembull,

kujtohet dhe thotë, e ngre në nivel kushtetues diskutimin dhe thotë, -Jo, akti që ka sjellë Këshilli i Lartë Gjyqësor, nëpërmjet Komisionit, pa kaluar në Këshill, është absolutisht i pavlefshëm sepse është jashtë kompetencës. Atëherë, çfarë bëhet me të gjithë vlerësimet e tjera, për më tepër në qoftë se kanë kaluar nga KPK-ja? Pra është diskutim vlefshmërie i aktit që përcjell ky Këshill.

Kështu që për të gjitha këto arsye, unë mendoj që ky raportimi duhet të kalojë në Këshill.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Në vazhdën e asaj që isha duke thënë qëparë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit do të vazhdojë të funksionojë për një periudhë 5-vjeçare, ndërkohë që sipas ligjit, nëse do të ketë ende gjyqtarë që nuk kanë kaluar procesin e rivlerësimit pas përfundimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, do të jetë Këshilli që do të realizojë procesin e rivlerësimit. Pra do të jemi në situatën kur duhet të bëhet edhe ky raporti i vlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit dhe ku Këshilli është pikërisht ai që duhet të bëjë edhe vlerësimin. Nuk e di si do përballet Këshilli me dy statuse, edhe duke bërë vlerësim për efekt të rivlerësimit por edhe duke bërë ai vlerësimin në kuadër të procesit të rivlerësimit. Lë të kujtohet që nuk mund të jetë i njëjti organ.

**Naureda Llagami:** Tjetër!

Kalojmë në...?

Jo! Kemi diskutim! Po!

**Brikena Ukperaj:** Edhe diçka tjetër. Në ndryshim nga Bruna, unë nuk mendoj që ky akt që i përcillet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe një herë i mëshoj, është akt vlerësues i aftësisë profesionale të gjyqtarit sepse në qoftë se do ta konstatoja të tillë, sigurisht që do thoja që do zbatohet Kushtetuta edhe do kalohet në mbledhje plenare. Ky akt, duke qenë një akt konstatues analizues, është ndihmës për procesin e rivlerësimit. Nga ana tjetër, vërtet është shfuqizuar dispozita e kompetencave të mbledhjes plenare, por vazhdojnë të ekzistojnë komisione që kanë funksione propozuese edhe funksione vendimmarrëse. Kështu që nuk mendoj që është e nevojshme që ta kalojmë në mbledhje, aq më tepër që si ne si KPK-ja, mbi të njëjtat standarde do punojmë, në qoftë se do ta shikonim vlerësim. Në qoftë se do ta shikonim vlerësim, në të njëjtat standarde që

parashikon ligji “Për statusin...”, do të arrinim në një konkluzion dhe të në njëjtat standarde që parashikon ligji “Për statusin...”, do të arrinte në konkluzion KPK-ja dhe prandaj mendoj që do të kishim mbivendosje të kompetencave për vlerësim.

*Naureda Llagami:* Zoti Toro!

*Alban Toro:* Edhe unë thjesht, me pak fjalë, i përmbahem vendimmarrjes që i takon Këshillit të shprehet për vlerësimin e këtij karakteri. E gjithë rregullorja flet për analizë të aftësive profesionale të subjektit, që në rastin konkret i nënshtrohet rivlerësimit, që do të thotë, pak a shumë janë të njëjtat kritere që aplikohen edhe me nenin 93 të ligjit “Për statusin e gjyqtarit/të magjistratit...”, që do të thotë, cenon në një farë mënyre direkt pozitën e tij përballë Komisionit të Rivlerësimit. Vendimmarrje të tilla, natyrisht që janë vendimmarrje që duhet t’i marrë Këshilli, si organi kompetent dhe që i përgjigjet edhe kompetencës që ai ka me Kushtetutë. Pastaj nëse kjo shërben si burim prove dhe vlerësohet nga KPK-ja si korrekt apo jo, për fat është ligji specifik ai që e ka adresuar atje, siç shërben për shembull edhe raporti i DSIK-së në rastin konkret të këtij Komisioni, i cili merr në konsideratë ose jo, pavarësisht se kemi të bëjmë me një institucion të specializuar në atë fushë, megjithatë KPK-ja e rivlerëson dhe e konsideron si burim prove pozitive dhe negative. Kështu që jam për variantin që, i takon Këshillit të përgjigjet për këtë pjesë.

*Naureda Llagami:* Të flas edhe unë?

Në fakt, edhe unë jam, deri diku, dakord me argumentimin e zotit Toro sepse mendoj se mund të kemi një problem në fakt me shfuqizimin e kompetencave të komisioneve dhe nëse neve në një rast të tillë do i hapim rrugë faktit që komisioni të ketë vendimmarrje, duhet automatikisht edhe në raste të tjera, qoftë për paraqitje, t’i hapim rrugë vendimmarrjeje komisionit, gjë që me sa duket, fryma e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, na e ka cenuar këtë pjesë. Dhe për të mbajtur standarde të njëjta se si operojnë tani komisionet edhe pse për efektivitet edhe për, le të themi, ekonomi pune të të gjithëve në këtu, sepse unë e mirëkuptoj faktin që nëse ne do mblidhemi, duhet të mblidhemi shumë shpesh për miratimin e këtyre raporteve. Por në kushtet që vendimmarrja e komisionit mund të cenohet për shkak të vendimit të Gjykatës

Kushtetuese, mund të krijoje primisa te ndodhemi para një situatë që me të drejtë edhe zonja Kadi u shpreh që mund të na cenohet vlefshmëria e raporteve.

Tani, në kushtet që ne nuk kemi një Gjykatë Kushtetuese ku ne t'i adresojmë këto lloj situatash, unë do të propozoja që ndoshta të fillojmë një iniciativë ligjore për mbushjen e vakumit që kemi në ligjin tonë për shkak të shfuqizimit të vendimit nga Gjykata Kushtetuese, është momenti që neve ndoshta edhe të reagojmë ndaj kësaj situatë sepse unë jam shumë e bindur që ne do ndodhemi në situatë të tjera, jo vetëm për komisionin përkatës por edhe për komisione të tjera, ku komisioni do bëjë vetëm një punë paraprake dhe duhet të vendosë mbledhja edhe për çështje që nuk janë kompetencë e mbledhjes së përgjithshme dhe duhet të vendosi për çdo lloj çështjeje. Ndoshta ky është momenti që unë sugjeroj që ne të krijojmë një iniciativë, pra të nisim iniciativën ligjore për përmbushjen e këtij vakumi ligjor të krijuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Unë thjesht u nxita edhe nga diskutimi që nisi Iliri për pjesën e kompetencës, çfarë ndodh pas përfundimit të afatit 5-vjeçar të funksionimit të KPK-së. Mendoj që nuk ka problem dhe përplasje kompetencash sepse sot deri në arritjen e atij afati, KLGJ-ja ka kompetencë të raportoje dhe bën edhe një lloj analize të dokumentit sepse nuk ia çon bruto atyre dokumentat, 5 dosje, të gjithë dokumentat që janë dorëzuar nga subjektet e rivlerësimit, bën një përshkrim të tyre dhe bën edhe një lloj analize, që është një fazë përpara vlerësimit, që e bën në fund KPK-ja. Në fund, kur t'i mbarojë afati dhe Kushtetuta ia jep këtë kompetencë KLGJ-së, nuk ka asnjë lloj përplasjeje që KLGJ-ja, pas atij momentit, përveç raportimit të analizës, do bëjë edhe vlerësimin. Kështu që unë nuk shikoj ndonjë problem këtu.

Edhe një moment tjetër që do diskutoja pro argumentit që e bën Këshilli është fakti që ky lloj raportimi, siç bëjnë edhe dy institucionet e tjera (pjesë e vlerësimit), ka një lloj përgjegjësie kur çohet aty ky raportim dhe kjo lloj analize. Tani, në qoftë se ligji thotë 'Këshilli' dhe ne ia lejmë Komisionit, në mënyrë indirekte do të thotë që ky Këshill ia ka deleguar kompetencat Komisionit dhe ka besim 100% që ai po shpreh vullnetin dhe vendimmarrjen e tij. Tani unë këtë s'e marr përsipër që përgjegjësinë time t'ia kaloj personave të tjerë dhe mendoj që përgjegjësia duhet të jetë e Këshillit. Dhe kur ne



miratojmë një raport, secili të ketë mundësinë ta vlerësojë vetë atë raportimin dhe atë analizën dhe gjithsekush të mbajë përgjegjësi. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, që ka shfuqizuar nenin 61 të ligjit “Për organet e qeverisjes”, unë vlerësoj që, në fakt edhe interpretimi që kanë bërë ata nuk është se i kanë hequr të gjitha kompetencat vendimmarrëse komisioneve, sepse neni 62 i ligjit që parashikon krijimin e komisioneve me kompetenca propozuese dhe vendimmarrëse, vazhdon të jetë në fuqi. Neni 62, madje thotë që komisionet, në të katër fushat që parashikon neni, karriera, etika, etj., etj., kanë kompetenca vendimmarrëse. Ajo që thotë Gjykata Kushtetuese është që këto komisione nuk mund të ushtrojnë kompetencat e mbledhjes plenare, pra nuk mund të ketë dublim të kompetencave, prandaj edhe Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi nenin 61 sepse tha që ti në këtë dispozitë ligjvënës, nuk i ke parashikuar të gjitha kompetencat kushtetuese. Problemi tjetër qëndron që çfarë natyre ka ky projekt-akt? Në qoftë se ky projekt-akt do jetë akt vlerësues, unë jam dakord të kalojë në Këshill. Por në qoftë se ky projekt-akt është thjesht një akt analizues, pra nuk ka nevojë për një vendimmarrje për të vlerësuar aftësitë e gjyqtarit, atëherë kjo është në kompetencë të Komisionit për ta përgatitur dhe për ta përcjellë. Në këtë logjikë e propozoj që të kalojë në Komision.

**Marçela Shehu:** Më fal! Kisha një pyetje për kolegun, për zotin Hallunaj, lidhur me, pikërisht me këtë që thotë Brikena, me natyrën e raportit që ju do të përcillni pranë KPK-së. Në nenin 4 të projekt-rregullores, ju parashikoni që është nëpunësi përgjegjës/inspektori që harton projekt-raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Pas paraqitjes së këtij projekt-raporti nga inspektori, cili është roli i komisionit? Pra që të kuptojmë edhe ne të gjithë natyrën e këtij raporti, analize që bën ky Komision. Pra, kush mund të ishin rastet që ky projekt-raport nuk do të votohej, nuk do të miratohej nga ky Komision? Pra, a ka ky Komision rol mosmiratimi dhe cilat mund të ishin këto raste?

**Dritan Hallunaj:** Atëherë, për sa i përket procedurës që ka marrë apo pretendohet që të marrë Komisioni, ka të bëjë me, projekt-raporti që përpilohet nga inspektori apo nëpunësi përgjegjës, varet nga terminologjia se si do të jetë emërtimi i tyre për efekt të statusit të tyre që do marrin pas miratimit të strukturës nga ana e Kuvendit të Shqipërisë,

pra pasi të jetë miratuar ajo, do jetë relatori i çështjes, pasi ai hedh vetëm materialin bruto, do jetë relatori i caktuar nga një nga anëtarët e Komisionit, i cili do ta kontrollojë, do ta verifikojë apo do të ndryshojë pikat ku mendohet që ka nevojë për ndërhyrje. Pastaj, Komisioni (që është varianti i parë) e hedh këtë raport të këtij relatori, e hedh në votim aty brenda Komisionit dhe është përcaktuar pastaj në nenet përkatëse mënyra e votimit, që me shumicë votash ose nëse barazohen, vota e kryetarit... Pra ka rol të rëndësishëm relatori i cili ndikon në raportimin, pra në atë material që është përgatitur.

Në vijim të kësaj dhe të asaj që tha edhe Brikena, unë personalisht jam me idenë që kjo vendimmarrje t'i takojë Komisionit. Nuk ka pse Këshilli të futet... Ose të kthehem pak mbrapa. Deri vonë, me dispozita tranzitore, kjo detyrë i ishte lënë Kryeinspektore dhe deri tani janë kryer, janë përpiluar rreth 110, 110 janë përpunuar si materiale, që janë dërguar me këtë mënyrë, pra që kanë qenë inspektor dhe Kryeinspektor i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ndërsa pjesa tjetër, diferenca, unë nuk e di pse do jetë kaq e nevojshme që kjo të futet në... të jetë Këshilli që të miratojë raportin pas përpilimit nga ana e relatorit përpara Këshillit.

Pa rënë në përsëritje, në lidhje me shfuqizimet që u tha, nga ana e Gjykatës Kushtetuese, përsëri e ka lënë krijimin e komisioneve dhe unë i qëndroj idesë – s'po bie në përsëritje – i qëndroj idesë që duhet të jetë vendimmarrje e Komisionit dhe jo e seancës plenare të Këshillit.

**Marçela Shehu:** Jo! Ajo që doja unë të isha më e qartë është kjo: Ky Komision, vetëm përcjell atë projekt-raport që përgatit punonjësi përgjegjës, vetëm e përcjell, apo... –Ta mbaroj pyetjen, se po të isha shumë e qartë, s'do ju pyesja.

...apo ky Komision ka fuqi vendimmarrëse që këtë raport ta refuzojë për një apo disa shkaqe të caktuara dhe cilat do të ishin këto shkaqe? Pra vetëm e përcjell këtë projekt-raport ashtu siç është apo mund të ketë raste të caktuara që unë nuk i pashë në rregullore se kush mund të jenë këto raste që ky raport të refuzohet nga ana e Komisionit.

**Maksim Qoku:** Besoj ta kuptova pyetjen

Ideja ka qenë që pranë çdo inspektori do ketë një... ose agjenti/nëpunësi vlerësimi, do caktohet një relator, një nga anëtarët e Komisionit. Çka do të thotë, një përgjegjësi e bashkëlidhur e të dyve, derisa ta bëjnë gati raportin për Komisionin. Çka do të thotë, nuk

flitet për ma bën inspektori, e kontrolloj unë dhe ia kthej apo e bëj unë dhe inspektori dhe ma kthen Komisioni. Flitet që ai do të punojë si personi direkt përgjegjës që nga shorti, unë do ta mbikëqyr si anëtar relator komplet punën deri në bërjen e raportit dhe këtë relativitet nën përgjegjësinë time si anëtar do ia bëj Komisionit. Dhe pastaj të 5-të vendosim ta çojmë çështjen, pra vlerësimin e konsiderojmë të mbaruar.

Po! E përcjellim. Nuk bëhet fjalë as për kthim, as për riparoje, as për kontroll. Pra të gjitha do bëhen njëkohësisht derisa ne të vendosim që ta çojmë.

Megjithatë, meqë e mora fjalën, ideja ishte këtu. Neve e dimë që ajo bëhej nga një inspektor dhe përcillej nga një Kryeinspektore. Ne menduam që e rritëm standardin kur bëjmë një komision. Tani, pajtueshmëria e Komisionit u bë në bazë të ligjit. Pra është një Komision që u votua nga seanca për këto kompetenca dhe me vendimin që morëm në mbledhjet e kaluara. Logjika është që ka një ligj 84 për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve që po të bëjmë një rast hipotetik ne, dhe sikur të bëjmë ne sot vlerësime për një gjykatës magjistrat pa kaluar në veting dhe sikur ta nxjerrim “Shumë mirë”, nëse ai kalon në veting në KPK, mund të rrëzohet. Pra sot neve, kam përshtypjen që ligji 84 “Për vlerësimin kalimtar...” vetëm na ka detyruar që në funksion të tij të bëjmë një nga kriteret, ai i vlerësimit dhe aktualisht ne jemi në funksion të atij vlerësimi që u duhet atyre. Kështu që ne thjesht, duke parë që jemi në respektim të atij standardi të mëparshëm, pra është një Komision me 5 anëtarë, por edhe vetë raporti i vlerësimit sipas atij shorti me 5 dosje në ato periudha ... thjesht në fotografim të asaj gjendjeje që ka magjistrati, themi që ky raport nuk ka nevojë që të shkojë deri në Këshill, përveç të tjerave për të ulur edhe këto burokracitë. Ndërsa përgjegjësia është tjetër gjë.

**Marçela Shehu:** Atëherë, me sa kuptova, në çdo rast, vendimi i këtij Komisioni do të jetë për miratimin dhe dërgimin. Pra nuk mund të ketë një vendimmarrje sipas kësaj rregulloreje dhe sipas asaj që ju shpjeguat, që ky projekt-raport nuk do të miratohet. Nuk do të ketë?

**Maksim Qoku:** Ne po kryejmë një detyrë. Pra duam të realizojmë një vlerësim dhe ky vlerësim është në pritje të një organi tjetër, të cilit duhet t’ia çojmë. Kështu që gjithçka është: e kryem, e kontrollojam, e rehatuam, e dërguam.

**Marçela Shehu:** Po pika 3 e nenit 8? Në të dyja variantet ka një parashikim. “Komisioni mund të vendosë për çështje të tjera që kanë lidhje me vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të gjyqtarëve si subjekte të rivlerësimit”. Cilat do të ishin këto çështje të tjera dhe raste kur...?

**Dritan Hallunaj:** Është në ligj dhe një ndër rastet, për t’i rënë shkurt, është problemi kur kërkohen... Për shembull kemi raste, që të lutem verifikoni filan ankesë për filan gjyqtar për efekt të vlerësimit. Pra është Komisioni ai që do ta vlerësojë nëse... pra do të merret me këtë pjesë dhe çështje të tjera, përveç asaj që është zgjedhur, pra 5 dosjeve, dosjet që ka zgjedhur vetë gjyqtari. Pra ka një mori kërkesash të tjera të cilat vijnë gjatë procesit të verifikimit të gjyqtarit, të cilat vijnë dhe paraqiten nga KPK-ja pranë Komisionit, për të cilat duhet një vendimmarrje e Komisionit për të vijuar, një ndër ato ishte kjo që përmenda, pra mund të kërkojnë shqyrtimin e një ankese, nga një anë e një qytetari a një subjekti, personi juridik apo fizik, për gjyqtarin dhe në këtë kuadër të rivlerësimit. Pra do jetë ky Komision që do të miratojë këtë (një nga ato raste, se ka edhe raste të tjera).

**Brunilda Kadi:** Në lidhje me përgjegjësinë, që përmenda edhe më përpara.

Tani, pse ligji ia ka ngarkuar dikur një organi monokratik siç ishte Kryeinspektori edhe pse më pas ia ka kaluar Këshillit, kjo nuk është çështja jonë. Ashtu e ka vlerësuar legjislatori. Në atë moment mendoi që ishte i besueshëm ai institucion që e bënte Kryeinspektori dhe ka menduar që kur të krijohet Këshilli, do ta ketë Këshilli dhe standardin e ka vendosur ligji. Kështu që ne nuk mund të vendosim një standard të mesëm midis Kryeinspektorit dhe Këshillit që na qenka Komisioni.

E dyta, kur ligji do t’i japë Komisionit vendimmarrje, e thotë shprehimisht, siç ishte rasti i Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e vendimeve kundër arkivimit të ankimeve. Kështu që mendoj se nuk na lë ligji të diskutojmë. Unë mendoj që, edhe pasi dëgjova argumentat e kolegëve, përfundimisht mendoj që duhet të jetë Këshilli.

**Brikena Ukperaj:** Në fakt, Kushtetuta, meqenëse është sipër ligjit Bruna, nuk ia ka ngarkuar inspektorit edhe KLGJ-së, ia ka ngarkuar organeve që kryejnë vlerësimin dhe duke qenë se në kohën para krijimit të KLGJ nëpunësit dhe inspektorët që kryenin vlerësimin ishin të atashuar pranë Inspektorit të Përgjithshëm, kjo është logjika që bënin

ata. Ndërsa aktualisht këtë kompetencë e ka Këshilli i Lartë Gjyqësor që vepron nëpërmjet organeve të veta. Dhe nga ana tjetër, në qoftë se ne, çdo gjë që ka të bëjë me këtë procesin e rivlerësimit, do ta kalojmë në mbledhjen plenare, mendoni që mbas dërgimit të raportit analizues që kërkohet për efekt të vlerësimit, këtu vijnë dhe shumë ankesa që vijnë për trajtim nga ana e subjektit apo ONM-ja të cilat duan përgjigje dhe në qoftë se do të ndjekim standardin që Komisioni, asnjë gjë nuk do ta kalojë pa mbledhje plenare, i bie që ne vetëm të mblidhemi, të diskutojmë këto ankesa. Ne nuk mbarojmë kurrë.

**Brunilda Kadi:** Ne po s'u mblodhëm për një rast ku bëhet fjalë për mbajtjen ose jo të gjyqtarit në detyrë?! Ne do mblidhemi për profesionalin periodik gjithmonë, e jo s'u mblidhemi për këtë?! Dhe e dyta, Kushtetuta nuk përmend as Këshillin, po të jetë për atë punë, e përmend ligji 84, i cili tërë kohës i është referuar Kushtetutës dhe figurën e Kryeinspektorit e ka ligji, nuk e ka Kushtetuta. Kushtetuta, po të jetë për atë punë, thotë 'nëpunës' dhe ne nuk jemi nëpunës. Kjo është e qartë.

Figurën e thotë ligji "Për rivlerësimin..." dhe ligji "Për statusin...", përcakton institucionet se kush merret konkretisht me tre figurat e rivlerësimit.

**Naureda Llagami:** Tani, e kalojmë në votim?

E do më njeri...? Ka njeri ndonjë...?

**Fatmira Luli:** Ta shpreh edhe unë opinionin tim?

**Naureda Llagami:** Po, patjetër!

**Fatmira Luli:** Edhe unë mendoj që është kompetencë e Komisionit dhe nuk është kompetencë e Këshillit. Ligji, kur bën fjalë për Këshillin, flet vetëm që përcjell këtë raport në organet e vlerësimit dhe nuk bën fjalë që është Këshilli ai në mbledhje që vendos lidhur me raportimin. Ai është një raportim analitik dhe për sa kohë s'është raport vlerësues, nuk ka pse të jetë kompetencë e Këshillit. Neni 62 i ligjit "Për qeverisjen e organeve të drejtësisë" e përcakton qartë që komisionet kanë fuqi vendimmarrëse dhe këtë fuqi s'ia ka hequr Gjykata Kushtetuese. Kështu që mendoj që është kompetencë e Komisionit dhe Komisioni duhet ta marrë vendimin.

**Naureda Llagami:** Të falenderoj!

Po, zoti Muharremaj!

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Desha të shtoj vetëm diçka në lidhje me diskutimin që bëri kolegja Kadi për sa i përket raportit Komisioni i Përhershëm-Këshill. I referohem këtu nenit 62, pika 13, për sa i përket një komisioni tjetër të përkohshëm, vendimi i të cilit nuk mund të ankimohet tek Këshilli. Kështu që, legjislatori i ka dhënë...

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

Të përfundoj, të lutem!

Vetëm të lutem, të përfundoj! Pastaj mund të vazhdoni juve.

Legjislatori i ka dhënë fuqi të plotë vendimmarrëse, në rastin konkret, një komisioni të përkohshëm. Prandaj unë gjykoj që në rastin konkret, ky komisioni i përkohshëm i ngritur nga Këshilli, mund të bëjë përcjelljen direkt të raporteve Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Faleminderit!

**Brunilda Kadi:** Ta saktësoj referimin që bëri kolegu, -jo, jo, se më citoi gabim.

Kur referova pikën 13 të nenit 62, nuk e referova direkt, por e thashë si përmbajtje. Thashë të kundërtën e asaj që po thoni ju. Thashë, kur ligji do që t'i japë fuqi vendimmarrëse komisionit (i përhershëm apo i përkohshëm), e thotë shprehimisht, siç është rasti që cituat ju dhe në rastin që po diskutojmë nuk është ky rasti, pra nuk ta thotë ligji ty shprehimisht, përkundrazi, ligji shprehimisht të thotë, nga fillimi deri në fund që e ka Këshilli këtë kompetencë.

**Marçela Shehu:** Kolegët thanë që vendimi i Komisionit është në çdo rast miratimi i raportit dhe dërgimi në KPK. Pika 2 e nenit 8 thotë: “Kryetari i Komisionit voton i fundit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese”. Për cilin rast është kjo situatë? Pra në qoftë se në çdo rast vendimmarrja është miratimi i projekt-raportit, kur është rasti që këto vota mund të ndahen në mosmiratim?

**Dritan Hallunaj:** Thelbi i asaj që tha kolegu Maksi ishte që, debatohet; hidhet në votim; nuk pranohet; i kthehet mbrapa për plotësim. Pra këtë koncept ka. Në fund pastaj ajo do të shkojë, një produkt do të shkojë atje. Produkti do shkojë. Nuk mund t'i themi atyre që ne këtë raport nuk do ta japim, se ne kemi vendosur që nuk e kalojmë dot. Ky është thelbi i asaj që tha kolegu.

**Naureda Llagami:** Atëherë, dëgjo! Fokusohemi! Kalojmë tek votimi. E kalojmë fillimisht parimisht dhe më pas diskutojmë variantin që pranojmë apo jo.

Dëgjo, parimisht jemi dakord me rregulloren.

Një votim do jetë për atë.

Atëherë, e hedhim për votim parimisht rregulloren.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, hedhim për votim variantin me Këshillin. Neni 8, por me variantin që raporti do i propozohet dhe miratohet në Këshill.

Po, varianti 2.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Kundër.

Kalojmë me variantin e Komisionit.

**Maksim Qoku:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

*(Vota e zonjës Luli nuk është regjistruar.)*

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Miratohet projekt-rregullorja “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës me variantin e parë, që do të thotë që, vendimet e Komisionit do të miratohen... pra me variantin e nenit 8 si më poshtë: “Komisioni, pas shqyrtimit të projekt-raportit të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratimin e tij. Kryetari i Komisionit voton i fundit. Kur vota ndahet në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese. Komisioni mund të vendosë për çështjet e tjera që kanë lidhje me vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të gjyqtarëve si subjekt të rivlerësimit”.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 07.02.2019)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

*Naureda Llagami:* Çështja e pestë e rendit të ditës është: Shqyrtimi i projektvendimit “Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, si dhe duke vlerësuar situatën e krijuar nga numri i madh i ankimeve kundër vendimeve të Inspektoratit të depozituara pranë Këshillit është propozuar nga Komisioni i Përhershëm Disiplinor ngritja e një Komisioni të Përkohshëm, i cili do të shqyrtojë të gjithë këto ankime. Krijimi i këtij Komisioni është parashikuar në mbështetje të nenit 62, pika 13 e ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes

së sistemit të drejtësisë”. Ky Komision vlerësohet të shqyrtojë të gjitha ankesat që janë paraqitur apo do të paraqiten pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me anë të së cilit është vendosur apo do vendoset arkivimi i ankesës pas shqyrtimit fillestar. Arkivimi i ankesës pas verifikimit shtesë të saj apo pushimi i hetimit ndaj një gjyqtari.

Për sqarime të mëtejshme të këtij projekt-akti, fjalën ia jap kryetarit të Komisionit Disiplinor, zotit Medi Bici.

**Medi Bici:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Ashtu siç e thatë edhe ju, duke parë fluksin e ankesave që janë në Këshill, Komisioni i Përhershëm i disiplinës i kërkon seancës plenare ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankesës ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari. Baza ligjore ku bazohet ky projektvendim është neni 62, pika 13 e ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i cili thotë: Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga dy gjyqtarë jo anëtarë (*lapsus, i përbërë nga dy anëtarë jo gjyqtarë*) dhe një anëtar gjyqtar. Përbërja e këtij Komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit. Vendimet e këtij Komisioni janë të pa ankimueshme dhe nuk i kalojnë mbledhjes plenare.

Në projektvendimin që kemi paraqitur ne i kemi pasqyruar të gjitha këto kërkesa të ligjit dhe kemi thënë që edhe sot mund të organizohet shorti ndërmjet anëtarëve jo gjyqtarë dhe anëtarëve gjyqtarë, ku nga katër anëtarët jo gjyqtarë, duhen dy anëtarë, ndërsa nga gjashtë anëtarët gjyqtarë, kërkohet që në Komision të jetë një anëtar. Kaq kishim. Ligji e shpreh, një Komision.

**Brikena Ukperaj:** Mund të shtoj vetëm diçka?

Edhe në projektvendim i referoheni Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në fakt, ky nuk është krijuar akoma. Sot ne shqyrtojmë vendimet për arkivimin e ankesave dhe pushimin e hetimit që ka bërë ish inspektori, ...Kryeinspektori, më fal për termin, Kryeinspektori. Ndoshta duhet të reflektojmë në vendim për këtë pjesë.

**Medi Bici:** Nuk është zgjedhur pra Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por të gjitha vendimmarrjet dhe i gjithë dokumentacioni që është grumbulluar në Inspektorat, duhet t'i kalojë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për vendimet e marra para, ne jemi detyruar t'i shqyrtojmë dhe t'i japim përgjigje njerëzve.

**Brikena Ukperaj:** S'e thua. Prandaj! Këtë po thoshim.

**Brunilda Kadi:** Në fakt edhe unë do ta bëja këtë pyetje që bëri Brikena.

A është parashikuar në projektvendim çfarë do bëhet me vendimet e arkivimit të Kryeinspektorit, i cili në periudhën tranzitore ka shqyrtuar ankimet dhe mund të ketë raste të arkivimit dhe ku mund të jetë bërë ankim, -një. E dyta, nëse po, do jetë kështu – se ndoshta, unë e lexova edhe përmbajtjen dhe nuk e kishte as titulli e as përmbajtja – nëse do jetë, unë kam pyetjen e dytë pastaj të radhës, - mbi çfarë baze ligjore do bëhet?

Meqë e mora fjalën, të bëj edhe pyetjen e tretë, - për sa kohë do ngrihet ky Komisioni i Përkohshëm? Se ankimet kundër vendimeve të arkivimit të ILD-së do ketë gjithë kohës. Ky Komisioni që do jetë i përkohshëm, për sa kohë do ta ketë këtë afat?

**Medi Bici:** Po e fillojmë nga pyetja e fundit.

Mendoj që Komisioni i Përkohshëm duhet të jetë deri në ngritjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Komisioni duhet të japi përgjigje letrave dhe duhet t'i thotë njerëzve që kjo kërkesë nuk i takon Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*Këshillit të Lartë Gjyqësor*), duhet të kalojë këtu. E do një përgjigje.

**Brunilda Kadi:** S'ka lidhje kjo. Ky është vendimi, Komisioni i Përkohshëm që e parashikon dispozita, neni 62, ku flet për komisionet dhe thotë që Këshilli, gjithë kohës do ketë një komision të përkohshëm i cili zgjidhet me short, - vazhdon, -për ankimet kundër vendimeve të arkivimit të ILD-së që do jetë tërë kohës, derisa të kemi ndonjë ndryshim tjetër kushtetues, që domethënë, do jetë deri në infinit.

Ky Komisioni jonë i përkohshëm, për sa kohë do ta ketë këtë afatin?

**Medi Bici:** Jam shumë dakord për këtë që thua, pasi të ngrihet institucioni i ri, por me të gjithë ankimet që bëhen nga njerëzit për gjyqtarët, derisa të ngrihet institucioni i ri, çfarë do bëhet?

**Naureda Llagami:** Zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, siç edhe kolegët konstatuan, duhet të përfshihet në këtë projektvendim edhe vendimmarrja që tashmë ka ndodhur nga Kryeinspektori, vendimmarrje që janë nxjerrë në zbatim të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, po ashtu edhe për sa i përket shqetësimit që ngriti zonja Kadi, mund të përcaktojmë një afat 1-vjeçar të këtij Komisioni që mund ta ngremë sot dhe ky Komision, pas 1 viti, të ripërtërihet me anëtarë të tjerë, që mos të jenë të njëjtët gjatë gjithë kohës. Ligji ka përcaktuar që është Komision i përkohshëm, që ngrihet rast pas rasti sipas ankesave që mund të vijnë, por që kjo ripërtëritja asnjëherë nuk është e dëmshme, përkundrazi, është e dobishme.

**Brikena Ukperaj:** Në fakt, ky projektvendim, erdhi siç na u shpjegua edhe nga relatori, për shkak të urgjencës që paraqet depozitimi aktualisht sot në Këshillin e Lartë Gjyqësor, i të gjithë praktikave që lidhen me ankimet ndaj vendimeve të arkivimit dhe të pushimit të hetimit të ish Kryeinspektorit. Mendoj që ngritjen e Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve ta bëjmë vetëm për këto vendime sepse nuk do kemi më të tilla derisa të ngrihet ILD-ja. Prandaj, me ndryshimet përkatëse bëjmë, duke qenë se kemi një shumë të konsiderueshme (180) të këtyre, bëjmë këtë Komisionin e përkohshëm sot, për të shqyrtuar vetëm këto ankesat ndaj vendimeve të arkivimit dhe të pushimit të hetimeve të ish Kryeinspektorit.

**Naureda Llagami:** Atëherë, propozimi konkret nga ana juaj është që të ndryshohet...

**Fatmira Luli:** Këtu është thënë ‘për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë’. Tani, bëhet fjalë për vendimet e Kryeinspektorit që ka qenë (ish Kryeinspektori). Kështu që, kjo do ndryshojë. Dhe afati të jetë në varësi të atyre vendimeve të arkivimit. Në momentin që mbarojnë ato, nuk ka më Komision.

**Brunilda Kadi:** Mundem?

**Naureda Llagami:** Po!

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë nuk mendoj se është çështje ‘t’i ndryshojmë kokën’, se është çështje koncepti njëherë, -e para. E dyta, siç edhe e shpjegoi kryetari i Komisionit të Disiplinës, ideja e tyre ka qenë për t’i dhënë drejtim ankimeve që vijnë në mënyrë të vazhdueshme ndaj gjyqtarëve, që është një gjë tërësisht e ndryshme nga ky akti

që na është sjellë këtu. Ashtu siç e konstatoi edhe Brikena, në vazhdim edhe të asaj që nisa të thosha unë, ky institucion (ILD-ja) nuk është ngritur akoma dhe ky Komisioni, për t'i dhënë përgjigje ankimeve kundër vendimeve të tij, është i pavlerë tani në këtë moment. Kur të ngrihet ILD-ja, e bëjmë edhe këtë vendimi. Diskutimi është që tani të bëjmë, çfarë do bëjmë me vendimet e ish Kryeinspektore, dhe për këtë unë mendoj që nuk mund ta marrim vendimin në mënyrë të menjëhershme, thjesht t'i ndërrojmë kokën, se është komplet koncept tjetër. Ta mendojë Komisioni i Disiplinës dhe të na sjelli propozim tjetër. Edhe bazën ligjore, po ka mundësi. Kjo baza ligjore këtu është për ILD-në, nuk është për Kryeinspektorin. Se ka edhe momente të tjera për të diskutuar: çfarë do bëhet edhe me afatet, në qoftë se u kanë kaluar afatet e ankimit, e shumë gjëra të tjera që unë mendoj se duhet të ketë kohën e vet Komisioni, që ta propozojë. Megjithatë...

**Maksim Qoku:** Tani, për të sqaruar pak idenë pse e mbajtëm me këtë kokë, meqë 62-shi thotë që ky Komision i përhershëm e ka këtë për vendimet e arkivuara të ILD-së, ne menduam që të bëjmë një kërkesë, një projektvendim për të miratuar këtë dhe pastaj ne t'i drejtoheshim Këshillit që të na autorizonte, që për të gjithë këto ankimet e periudhës së Inspektoratit derisa ne u konstituam, të autorizoheshim që t'i merrnim në shqyrtim. Pra ne kemi menduar me dy kohë. Menduam të bëjmë këtë, se është problem baza ligjore (62-shi).

**Brunilda Kadi:** Paskeni mendime të ndryshme.

**Maksim Qoku:** Mirë pra, kjo ishte ideja e asaj. Nuk kemi asnjë mendim të ndryshëm. E bëjmë këtë sepse respektojmë një bazë ligjore në atë çka thotë 62-shi, pika 13, por e padiskutueshme, do t'i kishim kërkuar autorizim Këshillit që për periudhën në të cilën jemi dhe nuk kemi ILD por kemi një vendimmarrje nga Kryeinspektori, të autorizohet ky Komision që të merret me periudhën deri në krijimin e ILD-së, e të gjitha ankesave të shqyrtuara nga Kryeinspektori.

**Brunilda Kadi:** Dhe pastaj do ta bëni më të vështirë procedurën për të kërkuar këtë autorizimin, -se unë nuk e di ku e gjeni bazën ligjore që një Komision i ngritur për një gjë, të kërkojë autorizim për të bërë një gjë tjetër. Thjesht, fjalën 'autorizim' unë për shembull nuk e gjej në ligj, as si koncept.

**Naureda Llagami:** Në fakt, nevoja për ngritjen e një komisioni është për shkak të një situatë që ne kemi në Këshill. Aktualisht ne kemi 183 ankime mbi vendimet e pushimit të procedimeve marrë nga Kryeinspektori. Kjo situatë është përpara se Këshilli të konstituohej. Pra nuk kemi një situatë që Këshilli ka qenë i konstituuar, ndërkohë që ato ankimet aty kanë ngelur të pa trajtuara. Ndërkohë që ILD-në, ne nuk e dimë kur do krijohet ILD-ja, nëse do krijohet ILD-ja dhe nëse këto çështje do jenë çështje për të cilat ne duhet t'ia kalojmë ILD-së sepse këto nuk i ka bërë në kohën që ka qenë e krijuar ILD-ja dhe për këtë arsye, qëllimi i krijimit të një komisioni, për të shqyrtuar këto lloj ankimesh, ishte për të rregulluar situatën që ne kemi aktualisht.

-Çfarë do bëhet me ato dosjet?

Nëse ju nuk e gjykoni që një komision i tillë duhet t'i trajtojë, më thoni konkretisht kush është propozimi konkret?

Është shumë komode sot që ne të vijmë dhe të bëjmë në një situatë kur të gjithë institucionet nuk janë ngritur, në një situatë ku kuadri ligjor na ngelet i copëzuar për implementimin dhe zbatimin e tij. Atëherë, kush janë propozimet konkrete nga ana juaj për të bërë, se është shumë e lehtë që ne të bëjmë oponencë dhe të themi që kjo nuk bëhet se s'e thotë ligji. Ne e dimë shumë mirë, se edhe ne e lexojmë ligjin këtu.

Ajo që diskutohet, hajde të jemi bashkëpunues, si t'i zgjidhim 183 ankesat që ne kemi këtu. Si do shprehemi për këto 183 ankesa? A mund të përbëjnë këto lëndë për ILD-në?

Jo! -Sepse këto janë gjykuar nga Kryeinspektorati.

Atëherë, ti thua që neve nuk i marrim dot sepse s'na vijnë dot nga ILD-ja.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

Ju thoni që neve (Këshilli) nuk i merr dot në shqyrtim sepse nuk është nga ILD-ja dhe Këshilli i ri duhet t'i marri për shqyrtim.

**Brunilda Kadi:** Nuk e thashë këtë gjë.

E para, në asnjë moment të fjalës time nuk thashë që nuk bëhet.

E para e punës, e pyeti Brikena dhe pastaj vazhdova unë dhe doli, nga gjithë diskutimi, që qëllimi është ndryshe me aktin që na është sjellë. Dakord?

Pra u bëka fjalë për vendimet e arkivuara të Kryeinspektores dhe qëllimi i aktit ka qenë për t'u marrë me këtë gjë, ndërkohë, projektvendimi është për të shqyrtuar ankimet kundër vendimeve të ILD-së. Pra mua, në mënyrë të qartë më del që qëllimi nuk më përputhet me projektvendimin dhe thashë, me logjikë, ndoshta Komisioni që e propozoi, mbase të qartësohet vetë se çfarë do na sjellë, të vijë të na propozojë rastin e vendimeve të arkivimit të Kryeinspektores. Të vijë me një projekt tjetër dhe hajde ta diskutojmë. Unë nuk thashë që s'bëhet. Thashë thjesht të biem dakord për çfarë po flasim. Mos e deformoni atë që thashë unë.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, shqetësimi dhe arsyeja pse Komisioni i Disiplinës ka përcjellë këtë projektvendim është fakti i arkivimeve të ndodhura tashmë sipas ligjit deri në këtë moment. Mundet që e gjitha kjo të adresohet në terma konkretë, siç tha edhe Brikena, mund të ngremë një Komision të shqyrtojë të gjitha ato ankime apo pushimet të ndodhura sipas ligjit deri më sot. Në këtë mënyrë kemi përcaktuar edhe objektin e veprimtarisë së këtij Komisioni edhe kohën gjatë të cilës duhet ta ushtrojë atë. Mundet, kur thashë 1 vit më herët, e thashë për arsyen e thjeshtë se Komisioni është i përkohshëm. Ne nuk mund të themi që ngrihet një Komision i Përkohshëm që vazhdon gjithë kohës. Brikena me të drejtë tha që mund ta kufizojmë në raport me numrin e atyre ankesave që janë tashmë atje, sa kohë do ketë një periudhë pauzë teorikisht, sepse Inspektori i Lartë Drejtësisë nuk është ngritur akoma, që mund të ketë ankesa të kësaj natyre këtu. Mund të jetë një nga zgjidhjet. I përket Komisionit propozues që t'i definojë më mirë këto të dyja dhe ne ta miratojmë vendimin.

**Naureda Llagami:** Komisioni propozues ka ndonjë gjë?

**Medi Bici:** Unë e thashë edhe një herë mendimin tim. Të gjitha vendimet që ka marrë Inspektori para datës së hyrjes në fuqi të ligjit, duhet të trajtohen nga ky Komision. Por ajo që më shqetëson, kjo fazë tranzitore, nga momenti i sotëm derisa të ngrihet/të funksionojë institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, çfarë do bëhet me ankimet që do vijnë nga njerëzit?

**Naureda Llagami:** Kjo është çështje tjetër.



Unë propozoj ta tërheqim këtë çështje nga rendi i ditës, të reflektojmë prapë dhe ta kalojmë në mbledhjen e radhës? Jemi dakord me këtë?

*(Anëtarët janë dakord.)*

Dakord.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 07.02.2019)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:50.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësues të USAID-it.*
- 7. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë tek çështja e fundit e rendit të ditës, e cila lidhet me një projektvendim mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore.

Sikurse jeni në dijeni, Këshillit të Lartë Gjyqësor, me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore i është besuar ndër të tjera edhe administrimi gjyqësor. Në këtë kontekst, Komisioni i Etikës dhe i Veprimtarisë Profesionale vlerëson informacionet periodike të kryetarëve të gjykatave drejtuar Këshillit, pasi në ato evidentohen çështje kryesore, për të cilat ky Këshill duhet të informohet. Në këtë këndvështrim, nga ky Komision, është përgatitur një projektvendim për të normuar këtë veprimtari. Për më tepër, fjala i jepet kryetares së Komisionit të Etikës, zonjës Lubonja.

*Brikena Ukperaj:* Atëherë, faleminderit!

Ashtu siç edhe ju Kryetare referuat, në fakt miratimi i këtij projekt-akti është kondicionuar nga një shqetësim të adresuar nga kryetarët e të gjitha gjykatave në një takim që ne kemi patur, lidhur me çështjet për të cilat ata duhet të informojnë Këshillin e

Lartë Gjyqësor tashmë, në kuadër të ridimensionimit dhe shtimit të kompetencave kushtetuese.

Ne si Komision i Vlerësimit të Etikës, pasi kemi shqyrtuar kuadrin ligjor dhe kemi parë edhe praktikën e mëparshme të mbajtur nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kemi parë materialet referuese që vinin nga kryetarët e gjykatave dhe kemi çmuar të nevojshme që të vendosim një mënyrë bashkëpunimi me kryetarët e gjykatave, të cilët duhet që të raportojnë periodikisht në një kohëzgjatje 3-mujore, për shembull të mos jetë raport i përmuajshëm, por edhe që të ketë mundësi për të përpunuar të dhënat, ky të jetë në një frekuencë 3-mujore.

Konkretisht kemi vlerësuar që duhet të raportohet, së pari, ngarkesa e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe për çdo gjyqtar, duke evidentuar numrin e çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse si dhe numrin e çështjeve të zvarritura tej afateve të arsyeshme të gjykimit, të parashikuara në nenin 399, pika 2 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me afatet e arsyeshme brenda të cilave duhet të përfundojnë çështjet dhe kjo pas reflektimit të praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

E kemi vlerësuar të nevojshëm marrjen e këtij informacioni sepse nga ligji, detyrohem që të mbikëqyrim në mënyrë të vazhdueshme ngarkesën e punës së gjyqtarëve dhe ruajtjen e efijencës së gjykatave; detyrohem që të përmirësojmë produktivitetin, por nga ana tjetër vlerësojmë që luan rol edhe në përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë dhe për propozimin e numrit të gjyqtarëve në përgjithësi, sipas kriterëve që parashikohen në ligj.

Sot, me miratimin e rregulloreve për transferimin edhe për delegimin, vlerësoj që ky informacion do të jetë shumë i dobishëm edhe për efekt të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Së dyti, kemi vlerësuar që duhet të raportohet nga ana e kryetarëve problematika që lind për shkak të respektimit të etikës dhe solemnitetit nga ana e trupës gjyqësore, jo vetëm sepse Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka për detyrë të mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme standardet e etikës së gjyqtarëve por edhe për shkak sepse ne në Këshill do të krijojmë Kodin Etik të gjyqtarit dhe evidentimi i problematikës do të na ndihmojë për të pasuruar rregullat që duhet të parashikohen në këtë Kod Etik.

Së treti, kemi vlerësuar që duhet të raportohet lidhur me nr. e kërkesave për heqje dorë që miratohen nga kryetarët e gjykatave për çdo gjyqtar si dhe numrin e vendimeve për përjashtim gjyqtari, që pranohen me kërkesë të palëve, për shkak të konfliktit të interesit, bashkë me emrin e gjyqtarit. Kjo sepse do t'i shërbejë shumë Komisionit të Vlerësimit si efekt i dosjes së vlerësimit sepse është një nga burimet e vlerësimit që merret parasysh për vlerësimin profesional, gjithashtu vlerësojmë që i bën gjyqtarët më të përgjegjshëm ndaj kërkesave për heqje dorë, çka do të reflektojë pastaj edhe në kërkesat për delegim apo transferim, por do të ndihmojë gjithashtu edhe në lehtësimin e të gjithë procesit të vlerësimit dhe jemi në dijeni që ndonjëherë edhe abuzohet me këto kërkesat për heqje dorë apo kërkesat për përjashtim gjyqtari.

Së katërti, vlerësojmë që duhet të raportohet për mënyrën e funksionimit se si funksionon në çdo gjykatë sistemi audio dhe cili është niveli i përdorimit të tij nga ana e gjyqtarëve. Sa është numri i seancave gjyqësore që zhvillohen në sistemin audio dhe sa është numri i tyre që mbahen me mjete të tjera; si dhe të evidentohet në përqindje, numri i seancave gjyqësore që fillojnë me vonesë. Nevojshmëria e marrjes së këtij informacioni lidhet me detyrën funksionale të KLGJ-së për të garantuar një sistem gjyqësor transparent dhe të përgjegjshëm, lehtëson procedurën e vlerësimit, por njëkohësisht informon Këshillin edhe lidhur me garantimin e efektivitetit dhe efijencës dhe transparencës formën më të përdorur për dokumentimin e veprimeve procedurale.

Së pesti, vlerësojmë që duhet të raportohet lidhur me gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përmirësimin e këtij sistemi sepse lidhet ngushtë me përgjegjësinë që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor lidhur me mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit.

Së gjashti, vlerësojmë që duhet të raportojnë edhe problematika që ka çdo gjykatë lidhur me vonesat dhe dorëzimin e vendimeve të arsyetuara dhe, bashkë me këtë edhe çdo problematikë tjetër të evidentuar.

Nga konsultimi me ligjin kemi konstatuar që ka edhe shumë kompetenca të tjera të kryetarit, por ato janë të një natyre urgjente, prandaj nuk mund t'i përfshijmë në këtë informacion periodik, të cilat duhet t'i raportojnë në mënyrë të menjëhershme Këshillit të

Lartë Gjyqësor, që kanë të bëjnë kryesisht me shkallët e papajtueshmërisë apo të kufizimit në funksion.

Lidhur me mënyrën se si do të dërgohet ky raportim, kemi vlerësuar që edhe për të qenë koherentë edhe për të qenë të shpejtë, ky raportim të bëhet në rrugë elektronike, nga adresa zyrtare e e-mailit të gjykatës respektive në adresën zyrtare të e-mailit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Raportimi do të përfshijë një periudhë 3-mujore, duke filluar janar-mars, e në vazhdim. Duhet të raportohet javën e parë të muajit respektiv, duke filluar me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nga java e parë e muajit prill 2019.

**Naureda Llagami:** Zonja Lubonja, shumë faleminderit për relatimin!

Në fakt, unë kisha vetëm një koment të vogël lidhur me paraqitjen në aspektin e teknikës legjislative të projekt-aktit, do dëshiroja që të bëhet numërtimi jo me bullet points (*bullets points*), por të ishte një numërtim me shkronja sepse edhe për efekt referimi do ishte më i saktë të kishim numërtimin sipas teknikës legjislative, gjë që do ta reflektojnë në zbardhjen e këtij vendimi.

**Brikena Ukperaj:** Në /a/, /b/, /c/...?

**Naureda Llagami:** Po! Patjetër! Se s'mund të bëjmë referime me 'pika të zeza'.

Për pjesën tjetër, kush e do fjalën, në qoftë se ka ndonjë koment apo vlerëson që duhet të jetë edhe ndonjë çështje tjetër për t'u përfshirë në përmbajtjen e projektvendimit?

**Dritan Hallunaj:** Shkurtimisht. Për mua dakord, se duhet të kemi një situatë dhe një pasqyrë të qartë mbi ecurinë apo problematikat e gjykatave, por periudha 3-mujore mua më duket shumë e gjatë. Them që këtë periudhën ta bëjmë 2 muaj.

**Brikena Ukperaj:** 2-mujore e kishe fjalën?

Atëherë, për t'iu dhënë kohë edhe kryetarëve për të patur një informacion të përpunuar sepse brenda 1 muaji do ngarkohemi shumë me informacione 1 muaj, 1 muaj, 1 muaj. Dhe nga ana tjetër, nisur edhe nga fakti që detyrimi ligjor, në fakt në muajin qershor ne duhet të raportojmë dhe të publikojmë një raport për sa i përket ngarkesës së çështjes, e menduam më operative për të operuar me këto 3-mujoret. Në qoftë se ka çështje urgjente, nuk do presin as një muaj, as dy muaj, por do ta raportojnë që të nesërmen dhe kjo ishte logjika e propozimit. Megjithatë, si të vendoset.

**Naureda Llagami:** Ju falenderoj!  
E kalojmë në votim në parim projekt-aktin?  
Jeni dakord me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit dhe i Etikës?

**Maksim Qoku:** Dakord.

*(Vota e zonjës Kadi nuk është regjistruar.)*

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Hedhim projekt-aktin në votim në tërësi tani? Projektvendimin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, sipas tekstit të propozuar nga Komisioni i Etikës dhe i Vlerësimit.

Ndonjë çështje tjetër?

Atëherë, ju faleminderit për prezencën dhe për kontributin tuaj në mbledhje.

Ju uroj, ditë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**